

VENDIM
Nr. 482, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2013-2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2013-2015, sipas lidhjes nr. 1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 167, datë 29.2.2012 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavaneve të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2013-2015”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha